



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3555/ 7 prot.

Datë 07.01.2026

V E N D I M
Nr. 20/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280

092 (dyqind e tetedhjetë mijë e nentedhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

Ankimues: Operatori ekonomik “KRIJON” SHPK me Nipt. K12023001A dhe adresë: Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë

Operatori ekonomik “BionicTech” SHPK me Nipt. M41406021N dhe adresë: Rruga “Stavri Themeli”, ZK 8220, vol.12, fq.23 me nr. Pasurie 8/307-N2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë e nente mijë e nentedhjetë e dy) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

II.2. Në datën 10.11.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 02.12..2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “KRIJON” SHPK	17,171,171 lekë	s’kualifikuar
2. “GAMMA” SHPK	17,900,000 lekë	kualifikuar
3. “AlMedical” SHPK	24,888,880 lekë	kualifikuar
4. “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK	21,367,162.71 lekë	s’kualifikuar
5. “BionicTech” SHPK	16,944,553.32 lekë	s’kualifikuar
6. “MEDFAU” SHPK	18,756,768.29 lekë	s’kualifikuar
7. “ISOMETRIC” SHPK	0 lekë	s’kualifikuar

II.4. Në datën 02.12.2025 operatori ekonomik "KRIJON" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

"1. Operatori ekonomik "KRIJON" sh.p.k. me NUIS K12023001A me dokumentacionin e paraqitur nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë: Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga OE rezulton se për artikullin nr.118, Maja per mikropipete 100- 1000 µL per PCR (Maja per mikropipeta me volum 100-1000 µL te pershtatshme per eppendorf, PCR gradë, RNA/DNA free; loë binding ADN/ARN (aftesi te ulet mbajttese per AND/ARN), sterile, me dopio filtër; Pako (10 kuti x 96 maja) pako 15 dhe për artikullin nr.120 "Maja per mikropipete 2- 20 µL per PCR" (Maja per mikropipeta me volum 2-20 µL te pershtatshme per eppendorf, sterile, PCR gradë, RNA/DNA free; low binding ADN/ARN (aftesi te ulet mbajttese per AND/ARN), low retention per te eliminuar mbajtjen e sasise se likuidit ne paretet e majes, me dopio filtër; Pako (10kuti x 96 maja), pako 15, OE ka deklaruar në ofertën teknike kompani prodhuese EPPENDORF por nuk ka ngarkuar katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull sic kërkohet në DST. OE për plotësimin e këtij kriteri ka ngakuar Raport testimi të lëshuar nga laborator LADR GmbH MVZ Bremen për këto artikuj, përkatësisht test të datës 18.11.2022 për artikullin maja për mikropipete 50- 1000 µL dhe të datës 14.09.2022 për artikullin Maja per mikropipete 2- 20 µL të Eppendorf SE. LPP përcakton detyrim të OE për të vërtetuar se plotëson kërkesat e përcaktuar në DST dhe në rastin konkret OE duhet të kishte ngarkuar në SPE katalog ose skedë teknike të prodhuesit për të vërtetuar lidhjen që ky operator ka me prodhuesin e këtyre produkteve, ku të vërtetohej dhe përputhja me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Për sa më sipër, me dokumentacionin e ngarkuar OE nuk e bind AK se produktet që ai ofron për këto artikuj, i plotësojnë kërkesat e AK. OE skualifikohet për mospërmbushje të KVK pika 2.3.3".

II.5. Në datën 02.12.2025 operatori ekonomik "BioncTech" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon

3. Operatori ekonomik "BIONICTECH" sh.p.k. me NUIS M41406021N me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë: Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Në kataloget e ngarkuar nga OE në SPE dhe verifikimi i specifikimeve të produkteve të ofruara me ato të kërkuara nga AK rezulton si më poshtë; Nr. Emertimi Specifikime e kerkuara

Specifikimet e ofruara nga OE 5

Balon I taruar 1 mL Material borosilikat; klasi A; jo me e vogel se NS 7/16; me tape polipropileni. Volumetric flask, plastic stopcock A 5 ml 7/16 7 Balon I taruar 100 mL Material borosilikat; klasi A; jo me e vogel se NS 14/23; me tape zmerile (diametri jo me i voget se 14mm dhe gjatësi bashkimi jo me vogel se 23 mm) Volmetric flask Class A 100ml me tape polipropilen, NS 21/12 (diametri 21mm dhe gjatësi bashkimi jo me vogel se 12 mm) 12 Balon I taruar 250 mL Material borosilikat; klasi A; me tape zmerile Volmetric flask Class A dhe polipropen stopper 14 Balon I taruar 50 mL Material Borosilikat; klasi A; jo me e vogel se NS14/23(diametri jo me i voget se 14mm dhe gjatësi bashkimi jo me vogel se 23 mm); me tape zmerile Material Borosilikat; klasi A; NS 21/12 (diametri 21mm dhe gjatësi bashkimi jo me vogel se 12 mm); me tape polipropileni 16 Balon I taruar 500 mL Material borosilikat; klasi A; me tape zmerile. Material borosilikat; klasi A; me tape polipropileni. 23 Cartridge ekstraktimi Sep-Pak ose ekuivalent C18 Classic Cartridge; 360 mg Sorbent per Cartridge; 55 - 105 μ m; 50/pk ose ekuivalent ne sasi SPE Extra C18 SPE column, 500mg, 50 μ m 41 Elermajer 150- 200 mL Qelqi me gryke te gjere Nuk ka me kapacitet 150-200ml 45 Ene kristalizuese 2 L Kapaciteti 2 L; xham Borosilikat 3,3. Diametri i Jashtëm 180 -200 mm Crystallizing dishes nuk ka të përcaktuar volumin 2 L 48 Film per PCR Sterile per pllakat PCR; Temp. : -40°C to 125°C; Trashesia: 2 mm - 2.3 mm; sealing film for pcr, temp -70-110°C; 141.5x77mm, trashësi nuk ka 83 Kolona SPE imunoafiniti Afla M1* Imunoafiniti; me kapacitet jo me pak se 100 ng Aflatoxine M1; me kapacitet per 50 g moster; paketim 100 copë për pako ose ekuivalent nesasi Mungon limiti i detektimit/kufiri i zbulimit 93 Leter filtri me diameter jo me shume se 130 mm; permasa te poreve 2.5 μ m; 100 copë për pako Plain circles , diameter 125mm mungon përcaktimi i permasave të poreve. 111 Maja per mikropipeta 30- 300 μ L Maja per mikropipete me volum 20-300 μ L e pershtatshme per mikropipete eppendorf. Jo sterile; te graduara; pa filter. Cat nr: 022492047 (05-403-58) ose ekuivalent. Paketimi: kuti (2qese x 500 tipsa) ose ekuivalent ne sasi. Maja pipete 10-300 μ L të graduara sipas Eppendorf. Mungojne parametrat e tjere të kërkuar (jo sterile, pa filter) 112 Maja për mikropipeta 0,5- 10 μ L Maja per mikropipeta me volum 0,5-10 μ L e pershtatshme per pipete eppendorf; Sterile, pa filter. Pako me nga 10 kuti (96 maja per kuti) Produkti i përcaktuar në ofertën teknike në broshura 11, faqe 5 me kod MJB034 nuk ekziston. OE nuk ka paraqit katalog/skede për këtë produkt. 129 Mikropipete 100-1000 μ L vellim I rregullueshem me ndarje graduese 1 μ L; shkalla e vëllimit 100-1000 μ L; eppendorf ose ekuivalent adjustable volume pipette me vellim I rregullueshem me ndarje graduese 5 μ L; shkalla e vëllimit 100-1000 μ L 131 Mikropipete 2–20 μ L 2–20 μ L me ndarje graduese 0.02 μ L adjustable volume pipette 2–20 μ L me ndarje graduese 0.1 μ L Nisur nga fakti që mangësitë e deritanishme të konstatuara në dokumentacinin e ngarkuar nga OE tregojnë

qartazi se OE nuk ofron artikujt e kërkuar nga AK në DST dhe cojnë në skualifikimin e OE, KVO për ekonomi në vlerësimin e ofertave vendos të mos vazhdojë krahasimin e mëtejshëm të specifikimeve teknike të ngarkuara nga OE me ato të kërkuara nga AK për artikujt e tjerë. OE skualifikohet për mospërmbushje të KVK pika 2.3.5”

II.6. Në datën 05.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.7. Në datën 11.12.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik “KRIJON” SHPK me numër ankimimi elektronik A/2025/6171, datë 11.12.2025 dhe me Nr. 3555/2025 Prot., datë 11.12.2025 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

“ Skualifikimi i ofertës ekonomike të shoqërisë “Krijon” sh.p.k. është i pabazuar në legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik dhe në të njëjtën kohë arsyeja e skualifikimit është e pamotivuar nga faktet dhe dokumentet e dorëzuara Autoritetit Kontraktues.

Për të vërtetuar pretendimin tonë, ju argumentojmë si vijon:

Shoqëria Krijon shpk është një operator ekonomik i interesuar për këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye ka marrë të gjitha masat për të depozituar në sistemin elektronik të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktues.

Në Dokumentat Standarte të Tenderit autoriteti kontraktues ka kërkuar artikujt:

Për artikujt e sipër përmendur shoqëria jonë ka dorëzuar katalogun ngarkuar në SPE katalog me emërtimin “Katalog art 111-140”. Konkretisht artikujt gjenden në faqen 20 dhe 23 të këtij katalogu ku dallohen qartë emërtimet e artikullit nr. 118 dhe nr.120. Artikujt janë prodhim i kompanisë EPPENDORF cituar edhe në ofertën teknike.

Në katalogun e ngarkuar në SPE evidentohen qartë specifikimet teknike për artikujt e cituar duke dhënë një indicie për plotësimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit. Gjykojmë se nëse autoriteti kontraktues kishte dyshime lidhur me katalogun e ngarkuar nga operatori ekonomik Krijon shpk mund ti kërkonte sqarime ofertuesit referuar nenit 90 të LPP-së.

Referuar nenit 77 të LPP-së dhe nenit 40 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 përcaktohet se operatorët ekonomikë dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit si a) mostra të mallit b) fotografi apo katalogë teknikë, c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Në këtë linjë arsyetimi, në zbatim të plotë të ligjit dhe në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga AK, argumentojmë se shoqëria jonë ka ngarkuar në SPE dokumentacionin e duhur për të vërtetuar se artikujt e ofruar janë konform specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Theksojmë se me dokumentacionin e ngarkuar nga shoqëria jonë, autoriteti kontraktues verifikon përputhshmërinë e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin kërkesat teknike dhe funksionale, siguron që artikujt e ofruar janë prodhim i së njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë.

Lidhur me pretendimin se operatori ekonomik duhet të kishte ngarkuar katalog për të vërtetuar lidhjen që ky operator ka me prodhuesin e këtyre produkteve, theksojmë se nuk qëndron. Lidhjen që OE ka me prodhuesin nuk e vërteton katalogu por autorizimi i prodhuesit dhe në rastin konkret për këto dy artikuj autorizimi nuk është kërkuar në dokumentat standarte të tenderit.

Nga sa më sipër, shoqëria Krijon shpk ka paraqitur ofertën e tij në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke vërtetuar se zotëron reputacion, besueshmeri dhe kapacitetet e duhura për të realizuar me sukses kontratën, ndërkohë që autoriteti kontraktues mbetet përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës lidhur me cilësinë e mallrave.

Në konkluzion të argumentimit, kërkojmë:

- *Kualifikimin e ofertës së Krijon shpk pasi plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktues.”*

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3555/1 prot., datë 12.12.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “KRIJON” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3555 prot, datë 11.12.2025.

II.9. Njëpërmjet shkresës me nr. 4251/4 prot., datë 19.12.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3555/2 prot., datë 22.12.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në rrugë elektronike vendimi i KSHA-së nr.155/2025.

I njëjti vendim është përcjellë njëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.4251/5 prot., datë 19.12.2025, protokolluar me tonën nr.3555/3 prot., datë 22.12.2025.

Referuar këtij vendimi konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se më datë 22.12.2025 është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

II.11. Në datën 14.12.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6180, datë 14.12.2025 dhe me Nr. 3581/2025 Prot., datë 15.12.2025 e operatori ekonomik “BionicTech” SHPK ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

“...Ne date 01.10.2025 jemi njohur me shpalljen e procedures . Ne date 10.11.2025 kemi marre pjese ne proceduren e hedhur ne sistemin e prokurimit publik. Ne daten 02.12.2025 jemi njohur me vleresimin dhe arsyet e refuzimit te ofertes sone . Ne daten 05.12.2025 jemi njohur me shpalljen e afateve te ankesave nga autoriteti kontraktor . - A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton 3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten

katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Në këtë kuadër, artikujt e ofruar nga operatori ekonomik përmbushin plotësisht kërkesat funksionale dhe teknike të dokumenteve të tenderit dhe, në disa raste, i tejkalojnë ato për nga kapaciteti, fleksibiliteti dhe efikasiteti operacional.

Nga analiza krahasuese e pajisjeve dhe materialeve laboratorike, rezulton se:

? Materialet janë të njëjta ose superiore (qelq borosilikat, klasa A);

? Kapacitetet volumetrike më të mëdha rrisin fleksibilitetin laboratorik;

? Diferencat dimensionale nuk ndikojnë në saktësinë apo funksionalitetin;

? Pajisjet ofrojnë përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare laboratorike.

Në përputhje me parimin e proporcionalitetit (neni 3 i LPP), përjashtimi i një oferte teknikisht ekuivalente ose superiore do të përbënte një masë të pajustificuar dhe disproporcionale ndaj qëllimit të procedurës së prokurimit.

I. SHKELJE E PARIMEVE NË RAST REFUZIMI

Refuzimi i ofertës sonë, pavarësisht përputhshmërisë funksionale dhe teknike, do të binte ndesh me:

? Parimin e konkurrencës së ndershme;

? Parimin e trajtimit të barabartë;

? Praktikën e konsoliduar të KPP për pranimin e produkteve ekuivalente.

II. KËRKESA

Në përfundim, në bazë të argumentimit teknik dhe juridik të paraqitur më sipër, kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës;

2. Rivlerësimin e ofertës sonë si teknikisht të vlefshme;

3. Zbatimin korrekt të parimeve të Ligjit nr. 162/2020 për Prokurimin Publik.”

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3581/1 prot., datë 16.12.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “BionicTech” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3555 prot, datë 11.12.2025.

II.13. Nëpërmjet shkresës me nr. 4251/8 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3581/2 prot., datë 24.12.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në rrugë elektronike vendimi i KSHA-së nr.158/2025.

I njëjti vendim është përcjellë nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.4251/9 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën nr.3815/3 prot., datë 29.12.2025.

Referuar këtij vendimi konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “KRIJON” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “Nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë: Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga OE rezulton se për artikullin nr.118, Maja per mikropipete 100- 1000 µL per PCR (Maja per mikropipeta me volum 100-1000 µL te pershtatshme per eppendorf, PCR gradë, RNA/DNA free; loë binding ADN/ARN (aftesi te ulet mbajttese per AND/ARN), sterile, me dopio filtër; Pako (10 kuti x 96 maja) pako 15 dhe për artikullin nr.120 “Maja per mikropipete 2- 20 µL per PCR” (Maja per mikropipeta me volum 2-20 µL te pershtatshme per eppendorf, sterile, PCR gradë, RNA/DNA free; low binding ADN/ARN (aftesi te ulet mbajttese per AND/ARN), low retention per te eliminuar mbajtjen e sasise se likuidit ne paretet e majes, me dopio filtër; Pako (10kut x 96 maja), pako 15, OE ka deklaruar në ofertën teknike kompani prodhuese EPPENDORF por nuk ka ngarkuar katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull sic kërkohet në DST. OE për plotësimin e këtij kriteri ka ngarkuar Raport testimi të lëshuar nga laborator LADR GmbH MVZ Bremen per këto artikuj, përkatësisht test të datës 18.11.2022 per artikullin maja për mikropipete 50- 1000 µL dhe të datës 14.09.2022 për artikullin Maja per mikropipete 2- 20 µL të Eppendorf SE. LPP përcakton detyrim të OE për të vërtetuar se plotëson kërkesat e përcaktuar në DST dhe në rastin konkret OE duhet të kishte ngarkuar në SPE katalog ose skedë teknike të prodhuesit për të vërtetuar lidhjen që ky operator ka me prodhuesin e këtyre produkteve, ku të vërtetohej dhe përputhja me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Për sa më sipër, me dokumentacionin e ngarkuar OE nuk e bind AK se produktet që ai ofron për këto artikuj, i plotësojnë kërkesat e AK. OE skualifikohet për mospërmbushje të KVK pika 2.3.3”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të modifikuar pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është parashikuar si vijon:

3. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të modifikuar pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është parashikuar si vijon:

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt objekt prokurimi në formë tabele, ku të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit.

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “KRIJON” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Katalog_art_111-140

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 36 , të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi 8 ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i

kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se kriteret kualifikuese të parashikuar në pikën 2.3.3 dhe 2.3.6 nga ana e autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me njëri tjetrin ndaj dhe Komisioni në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacionit të dorëzuar prej tij në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e këtyre kriterëve do ti referohet në total kriterëve pasi përmbushja apo mospërmbushja e tyre lidhet me secili kriter.

III.1.10. Referuar kriterëve të veçantë të kualifikimit rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht në pikën 2.3.3 që operatorët ekonomikë ofertues, të paraqesin katalogët e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për të gjithë artikujt objekt prokurimi. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “KRIJON” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike ndër të tjera dhe dokumentacionin si vijon:

- Katalog_art_111-140 në të cilën janë përfshirë dhe specifikimet teknike për artikujt 118 dhe 120 për të cilat është skualifikuar nga procedura e prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht në pikën 2.3.3 të DST. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Referuar verifikimit dokumentacionit të operatorit ekonomik “KRIJON” SHPK rezulton se në sistemin e prokurimit elektronik ky operator ekonomik ka depozituar për artikullin 118 dhe artikullin 120 Test Raport të kryer pranë laboratorit LADR

218	Tub centrifuge konik	Tub centrifugues i graduuar ,me baze konike me kapacitet 100 ml. dhe gjatesi 200 mm , sipas standartit ASTM D96	Copë	10

219	Tuba eppendorf 2.0 mL	Tuba eppendorf ose ekuivalent 2.0 mL;material plastik;në formë konike ;me mbyllje të sigurtë të pavidhosur;që përdoren në - 80 grade celcius (Eppendorf ose ekuivalent Microcentrifuge Safe-Lock Tubes);paketimi (Pako/ 500 copë ose ekuivalent ne sasi)	Pako	26
220	Tuba për centrifuge 15 mL	Material polipropilen; te graduar;me kapak;me fund konik;me permasa afersisht (17x120 mm) paketim (100 copë për pako ose ekuivalent ne sasi)	Pako	109
221	Tuba qelqi me fund te rrumbullaket	Tuba qelqi; te autoklavizueshme me diametri 6-10 mm; gjatesia 75 mm. 50 cope/kuti ose ekuivalent ne sasi	Kuti	10
222	Tuba qelqi me tape të vidhosur	Glass Test Tube With Screw Cap. (në formë U-je; me fund të rrumbullakët) Material: Boro 3.3 glas. Pa ngjyrë. Gjeresia e tubit 15 mm dhe gjatësia 160 mm (±10%). kuti prej 100 copesh ose ekuivalent ne sasi	Kuti	2
223	Tuba testimi 16X160 mm	Borosilicate glass 3.3; tuba pa buze; permasat 16X160 mm; trashesia tubit; 1.0 - 1.2 mm;	Copë	200
224	Tuba testimi 18X180 mm	Borosilicate glass 3.3; pa buze; 32 mL	Copë	200
225	Vacuum filter set (per filtrimin e tretesave organik)	vacuum flask kapaciteti 1000ml; filter funnel kapaciteti 500ml; support i filtrit dhe kapese	Set	3
226	Valvula per kolonat SPE	Material plastik; Valvul per kontrollin e rrjedhjes ne kolonat SPE; Pako me nga 12 copë ose ekuivalent ne sasi	Pako	5

227	Varese vertikale per mikropipeta	varese vertikale per mikropipeta; me 6 ndenjese me mekanizem te rrotullueshem per mikropipeta Ependorf ose alternative.	Copë	2
228	Vasketa per peshim kampionesh	material polistiren; te bardha; me permasa rreth 4.5 cm x 4.5 cm x 0.7 cm; 500 copë për pako ose ekuivalent ne sasi	Pako	8
229	Viale HPLC 2 mL	Viale qelqi te erreta 2 mL per HPLC; me kapak te vidhosur; me marking spot. paketim (100 copë për pako ose ekuivalent ne sasi)	Pako	130
230	Viale HPLC plastike	Viale plastike 1.5-2 mL per HPLC; me kapak te vidhosur; paketim (100 copë për pako ose ekuivalent ne sasi)	Pako	26
231	Viale per insekte	Vial me kapacitet 3-4 mL dhe dimensione te jashtme perafersisht 15 mm dhe 45 mm me tape. 12 copë për pako ose ekuivalent ne sasi.	Pako	2
	Shenim: Furnizimi per artikujt me asteriks (*) do te behet me			
	nje diference kohe 6 muaj ne raportin te perafert me gjysmen e sasise.			

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "BIONICTECH" SHPK, ka paraqitur:

- AUTORIZIM_ISUV
- broshura_1_compressed
- broshura_2_compressed
- broshura_3_compressed
- broshura_4_compressed
- broshura_5_compressed
- broshura_6_compressed
- broshura_7_compressed
- broshura_8_compressed
- broshura_9_compressed
- broshura_10_compressed

- broshura_11_compressed
- broshura_12_compressed
- Oferta_Teknike_ISUV_Ene_Laboratorike
- Lista_e_cmimeve_ISUV_Ene_Laboratorike

III.3.4. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.4. Në nenin 40 pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.3.5..Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare,

miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.3.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.5 Balon I taruar 1 mL**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin Balon I taruar 1 mL, specifikimet si vijon: “*Material borosilikat; klasi A; jo me e vogel se NS 7/16; me tape polipropileni*”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar, broshura 11, në faqen 45 nga ku evidentohet artikulli Volumetric flask plastic stopcock A 5 ml 7/16 me prodhues Auxilab. Referuar këtij specifikimi të përcaktuar në DST ku kërkohet Material borosilikat; klasi A; jo me e vogel se NS 7/16; me tape polipropileni., konstatohet se ky specifikimi përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 7 Balon i taruar 100 mL** Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 7 Balon I taruar 100 mL, specifikimet si vijon: “*Material borosilikat;klasi A;jo me e vogel se NS 14/23; me tape zmerile.*”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 10, në faqen 23 dhe 29 nga ku evidentohet artikulli Volmetric flask Class A dhe glass stopper me prodhues Auxilab dhe me NS nga 12/21 deri në 14/23 dhe tapë qelqi. Referuar këtij specifikimi të përcaktuar në DST ku kërkohet Material borosilikat; klasi A;jo me e vogel se NS 14/23; me tape zmerile., konstatohet se ky specifikimi përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Përcaktimi I llojit të tapës në gjykim të KPP nuk përbën arsye skualifikimi përse kohë që tapa nuk përbën element thelbësor në funksionimin e pajisjes.Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 12 Balon i**

taruar 250 mL Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 12 Balon I taruar 250 mL, specifikimet si vijon: “*Material borosilikat; klasi A; me tape zmerile.*” Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 10, në faqen 23 dhe 29 nga ku evidentohet artikulli Volmetric flask Class A dhe glass stopper me prodhues Auxilab dhe me NS nga 12/21 deri në 14/23 dhe tapë qelqi. Referuar këtij specifikimi të përcaktuar në DST ku kërkohet Material borosilikat;klasi A;jo me e vogel se NS 14/23; me tape zmerile., konstatohet se ky specifikimi përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Përcaktimi I llojit të tapës në gjykim të KPP nuk përbën arsye skualifikimi përsa kohë që tapa nuk përbën element thelbësor në funksionimin e pajisjes. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 14 Balon I taruar 50 mL** Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 14 Balon I taruar 50 mL, specifikimet si vijon: “*Material Borosilikat; klasi A; jo me e vogel se NS 14/23; me tape zmerile.*” Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 10, në faqen 23 dhe 29 nga ku evidentohet artikulli Volmetric flask Class A dhe glass stopper me prodhues Auxilab dhe me NS nga 12/21 deri në 14/23 dhe tapë qelqi. Referuar këtij specifikimi të përcaktuar në DST ku kërkohet Material borosilikat; klasi A;jo me e vogel se NS 14/23; me tape zmerile., konstatohet se ky specifikimi përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Përcaktimi i llojit të tapës në gjykim të KPP nuk përbën arsye skualifikimi përsa kohë që tapa nuk përbën element thelbësor në funksionimin e pajisjes.Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 16 Balon I taruar 500 mL** Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 16 Balon I taruar 500 mL, specifikimet si vijon: “*Material borosilikat; klasi A; me tape zmerile.*” Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar

katalogun e markuar broshura 10, në faqen 23 dhe 29 nga ku evidentohet artikulli Volmetric flask Class A dhe glass stopper me prodhues Auxilab dhe me NS nga 12/21 deri në 14/23 dhe tapë qelqi. Referuar këtij specifikimi të përcaktuar në DST ku kërkohet Material borosilikat; klasi A; jo me e vogël se NS 14/23; me tape zmerile., konstatohet se ky specifikimi përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Përcaktimi I llojit të tapës në gjykim të KPP nuk përbën arsye skualifikimi për sa kohë që tapa nuk përbën element thelbësor në funksionimin e pajisjes. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.5 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 23 Cartridge ekstraktimi**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 23 Cartridge ekstraktimi, specifikimet si vijon: “Sep-Pak ose ekuivalent C18 Classic Cartridge; 360 mg Sorbent per Cartridge; 55 - 105 µm; 50/pk ose ekuivalent ne sasi..” Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 11, në faqen 66 nga ku evidentohet artikulli 011 SPE-5812-DDD03 m specifikime SPEExtra c18 SPE column, 50 µm, 500 mg 3ml, 50pcs , konstatohet se ky specifikimi përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik dhe është në tejkalim të specifikimeve të kërkuara. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.6 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 41 C Elermajer 150-200 mL** Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 41 Elermajer 150-200 mL, specifikimet si vijon: “Qelqi me gryke te gjere.. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 6, në faqen 29 nga ku evidentohet artikulli erlenmeyer flask eide neck me kapacitet nga 50-1000ml, ku konstatohet se specifikimi i kërkuar nga ak përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se

dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.7 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 45 Ene kristalizuese 2 L**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 45 Ene kristalizuese 2 L, specifikimet si vijon: “Kapaciteti 2 L; xham Borosilikat 3,3. Diametri I Jashtëm 180 -200 mm”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura7, në faqen 43 nga ku evidentohet artikulli Crystallizing dishes pa grykë me mbishkrim të bërë prej qelqi borosilikat me diametër 190 mm, ku konstatohet se specifikimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.8 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 48 Film per PCR**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 48 Film per PCR, specifikimet si vijon: “Sterile per pllakat PCR; Temp.: -40°C to +125°C; Trashesia: 2 mm - 2.3 mm; 100 copë për pako..” Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 9, në faqen 38 nga ku evidentohet artikulli sealing film for pcr, temp -70°C to +110°C ku konstatohet se specifikimi i kërkuar nga ak përmbushet nga artikulli i paraqitur nga operatori ekonomik është brenda intervalit të kërkuar dhe përsa kohë në specifikime nuk kemi të bëjmë me një dipazon minimum apo maksimum temperature por një interval gradacioni të temperaturësre specifikimi i paraqitur nga artikulli i operatorit ekonomik quhet i përmbushur. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.9 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 83 Kolona SPE imunoafiniti Afla M1***, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6

“Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 83 Kolona SPE imunoafiniti Afla M1*, specifikimet si vijon: “Imunoafiniti; me kapacitet jo me pak se 100 ng Aflatoxine M1; me kapacitet per 50 g moster; paketim 100 copë për pako ose ekuivalent ne sasi”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 8, në faqen 45 nga ku evidentohet artikulli Immnuiafinity Column e prodhuesit Chromoservis me të dhënat Aflatoxine B1, Aflatoxine B21 Aflatoxine G1 me kufi zbulimi 10 ppt duke përmbushur kështu specifikimet e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.10 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 93 Leter filtri**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 93 Leter filtri, specifikimet si vijon: “me diameter jo me shume se 130 mm; permasa te poreve 2.5 µm; 100 copë për pako”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 8, në faqen 25 nga ku evidentohet artikulli Plain circles e prodhuesit Frisnette me të diametwr nga 55 mm deri nw 150 mmme gradw nga 2-3 µm 5-8 µm, 8-12 µmdhe 12-15 µm duke përmbushur kështu specifikimet e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.11 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 111 Maja per mikropipeta 30- 300 µL**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 111 **Maja per mikropipeta 30- 300 µL**, specifikimet si vijon: “Maja per mikropipete me volum 20-300 µL e pershtatshme per mikropipete eppendorf. Jo sterile; te graduara; pa filter. Cat nr: 022492047 (05-403-58) ose ekuivalent. Paketimi: kuti (2qese x 500 tipsa) ose ekuivalent ne sasi.”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 11 në faqen 53 nga ku evidentohet artikulli pipette tips 10-300 µL e prodhuesit Witege duke përmbushur kështu specifikimet e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në

përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.12 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 114 Maja për mikropipeta 0,5-10 µL**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 114 Maja per mikropipeta 30- 300 µL, specifikimet si vijon: “Maja per mikropipeta me volum 0,5-10 µL e pershtatshme per pipete eppendorf; Sterile, pa filter. Pako me nga 10 kuti (96 maja per kuti)”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 11 në faqen 5 nga ku evidentohet artikulli non filter tips e prodhuesit Auxilab me specifikimet Maja per mikropipeta me volum 0,5-10 µL e pershtatshme per pipete eppendorf; Sterile, pa filter. duke përmbushur kështu specifikimet e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.13 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 129 Mikropipete 100-1000µL**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 129 Mikropipete 100-1000µL, specifikimet si vijon: “vëllim i rregullueshem me ndarje graduese 1µL; shkalla e vëllimit 100-1000µL; eppendorf ose ekuivalent”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 10 në faqen 9 nga ku evidentohet artikulli adjustable volume pipette e prodhuesit Auxilab me specifikimet me vëllim të rregullueshëm me ndarje graduese 1µL; shkalla e vëllimit 100-1000µL. duke përmbushur kështu specifikimet e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.6.14 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin 131 Mikropipete 2–20 µl**, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 6 “Formulari

i Specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar për artikullin 131 Mikropipete 2–20 µL, specifikimet si vijon: “2–20 µL me ndarje graduese 0.02 µL”. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se për këtë artikull operatori ekonomik ka dorëzuar katalogun e markuar broshura 10 në faqen 9 nga ku evidentohet artikulli adjustable volume pipette e prodhuesit Auxilab me specifikimet mikropipete 2–20 µL me ndarje graduese 0.1 µL duke përmbushur kështu specifikimet e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra, sipas konstatimeve të mësipërme, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij specifikimi teknike është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KRIJON” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje

enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

1. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK, duke e kualifikuar atë.
2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

